# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-451465**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rikthehet në vëmendje “Lugina e Ujqërve”, seriali i rekordeve nën hetim, çfarë lidhje ka me vdekjen e ish-agjentit të shërbimit sekret turk? – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/rikthehet-ne-vemendje-lugina-e-ujqerve-seriali-i-rekordeve-nen-hetim-cfare-lidhje-ka-me-vdekjen-e-ish-agjentit-te-sherbimit-sekret-turk/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 08:47:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 08:41:20 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e86269c94c4f95110e4c55606dc6c8c54d3e55c35dc2669cde2924892aa53900` |
| TEKSTI | `89a78f74711fbfde4d1ebf50e42ec316d0c3f97787e6e44e5974f6e091b602f5` |
| PAMJA | `3582176470dbb5ff946e473e20a60fe0e28dde865c9006b977d5252043764d31` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a78d9093c8a3d2980f01405e5403e45832744b4debd6bdbf97d74ed806177a7a` |
| E MËPARSHMJA | `9137c5fa21072d60bf300265733e04487281f1e380c714141a88c99a9984b76b` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a78d9093c8a3d2980f01405e5403e45832744b4debd6bdbf97d74ed806177a7a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Ilustrim · Vizion Plus

Hetimi për vdekjen e ish-pjesëtarit të Shërbimit Kombëtar të Inteligjencës së Turqisë (MIT), Kaşif Kozinoğlu, i cili humbi jetën në burgun e Silivrit në vitin 2011, është rihapur pas më shumë se një dekade. Në kuadër të hetimit të ri, autoritetet turke kanë vendosur të shqyrtojnë edhe disa episode të serialit të njohur “Kurtlar Vadisi Pusu”, për shkak të ngjashmërive të pretenduara mes ngjarjeve në serial dhe rrethanave të vdekjes së Kozinoğlu

“Lugina e Ujqërve” ka qenë seriali i cili në Turqi ka arritur rekorde duke boshatisur rrugët e qyteteve në orarin e transmetimit. Të njëjtin impakt ka patur edhe në vendin tonë kur transmetohej në atë kohë në Vizion Plus.

Në serial shfaqet personazhi fiktiv Kazım Kaşifoğlu, i cili është lidhur nga hetuesit me Kozinoğlu. Vëmendje të veçantë ka tërhequr episodi i transmetuar më 10 nëntor 2011, vetëm dy ditë para vdekjes së Kozinoğlu-t. Në atë episod, Kaşifoğlu paraqitet i mbajtur në një qeli, dhunohet dhe kërcënohet. Kozinoğlu, ndërkohë, vdiq më 12 nëntor 2011 në burgun e Silivrit.

Një tjetër skenë që po shqyrtohet është ajo e episodit 139, të transmetuar më 8 dhjetor 2011, rreth një muaj pas vdekjes së Kozinoğlu-t. Në këtë skenë, Kaşifoğlu shfaqet pasi kishte bërë ushtrime fizike dhe ankohet se i është rritur pulsi. Më pas hyn në dush dhe personazhi “Kara” e vret duke i injektuar ajër me shiringë. Hetuesit po shqyrtojnë edhe elemente të tjera

5 Dënimet në Hagë, reagon Vuçiç: Edhe pas 25 vitesh nuk jemi gati ta...

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

të serialit, përfshirë një automjet me targën “34 FG 7061”, për të përcaktuar nëse këto detaje kanë ndonjë lidhje me çështjen apo janë thjesht pjesë e skenarit.

Në një episod tjetër shfaqet një gur varri ku shkruhet “Erdoğan”.

Skenaristi Raci Şaşmaz deklaroi se ideja që një gur varri të përdorej për të dhënë një mesazh lidhur me Erdoğan-in dhe familjen e tij “nuk është në përputhje me vlerat në të cilat besojmë dhe një gjë e tillë nuk ka ndodhur”.




Në kuadër të hetimit, skenaristët **Raci Şaşmaz, Bahadır Özdener dhe Cüneyt Aysan** u thirrën për të dhënë informacion si persona në dijeni të çështjes. Ndërkohë, varri i Kozinoğlu-t u hap më 12 shtator dhe nga ekspertët u morën mostra për ekzaminim mjeko-ligjor, me qëllim përcaktimin e shkakut të saktë të vdekjes dhe nëse ka pasur ndërhyrje të personave të tretë. Hetimi vazhdon dhe deri tani pretendimet lidhur me serialin janë objekt verifikimi, jo përfundime të provuara nga autoritetet.

/vizionplus.tv

#hetim #LuginaeUjqërve #luginaeujqerve

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



BOTA
**La burrin e saj të sëmurë 19 orë në...**
Xhuljana Zhuleku · 2 orë më parë



BOTA
**Turqia dënon ashpër sulmin në Mekë**
Xhuljana Zhuleku · Dje 23:09



BOTA
**Italia heq taksën e qarkullimit, Tajani:...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 20:14

## Lini një koment

**Komenti juaj** *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

**Emri** * **E-mail** *




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.